

Fall 11-2010

KONTROLL-REVIZIONIMI BANKAR

Fatmire Ukaj

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

Recommended Citation

Ukaj, Fatmire, "KONTROLL-REVIZIONIMI BANKAR" (2010). *Theses and Dissertations*. 2505.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2505>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Universiteti për Biznes Dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

KONTROLL-REVIZIONIMI BANKAR
Shkalla Baçelor

Studentja: Fatmire Ukaj

Prishtinë, 2010



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

PUNIM DIPLOME

Viti akademik 2007/2008

Fatmire Ukaj

KONTROLL-REVIZIONIMI BANKAR

Mentori: Prof. Dr. Hajrullah Gorani

Nëntor 2010

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

PËRMBAJTJA

-I- HYRJE	4
1. MBIKEQYRJA DHE NOCIONI I MBIKQYRJES	4
1.1. TRAJTAT E MBIKEQYRJES	5
-II-	8
2. BANKAT DHE SISTEMI BANKAR NË KOSOVË.....	8
2.1. Llojet e bankave	10
2.2. Banka komerciale (depozitarë)	11
2.3. Sistemi bankare në Kosove	11
-III-	13
3. KONTROLLI I MARREDHENJEVE ME BANKA.....	13
-IV-	14
4. REVIZIONI I RAPORTEVE FINANCIARE I BANKAVE.....	14
AFARISTE.....	14
4.1 Përgjegjësia e Menaxhmentit të Bankës	14
4.2. Roli i mbikëqyrësit bankar	15
4.3 Roli i revizorit të jashtëm të bankës	17
4.4 Marrëdhëniet mes mbikëqyrësve dhe revizorëve.....	19
të jashtëm	19
4.5. Procedura e revizionit të një banke	20
-V-	29
5. PËRPILIMI I RAPORTIT TË REVIZIONIMIT	29
Përfundimi	31
Literatura	32

-I- HYRJE

1. MBIKEQYRJA DHE NOCIONI I MBIKQYRJES

Marre në përgjithësi “të mbikëqyresh” do të thotë të vëzhgosh me kujdes kryerjen e një detyre, zbatimin e ndonjë porositë, apo mos shkeljen e ndonjë rregulli, udhëzimit që janë në përputhje me ligjet në fuqi¹. Në veprimtarin afariste të ndërmarrjeve, mbikëqyrja do të thotë ndjekjen me vëmendje të një pune, të një veprimtarie ashtu që çdo gjë të jetë në rregull, pra të jetë në përputhje me normat e caktuara me rregullore, udhëzime apo me ligje. Kemi mbikëqyrje teknike, ekonomike, kontabile dhe mbikëqyrje të tjera.

Çdo veprimtari i ka specifiket e veta madje edhe çdo ndërmarrje. Andaj për mbikëqyrjen e tyre kërkohen edhe specialist përkatës. Mbikëqyrjen duhet kuptuar si diçka krejt e natyrshme e të domosdoshme. Nëse bëhen planet për ndërmarrje afariste caktohen objektivat që duhet realizuar, bëhen përgatitje të duhura duke angazhuara mjetet në para e në sende, duke angazhuare fuqinë punëtore etj., pa të cilat nuk është mundur mbikëqyrja dhe realizimi i këtyre planeve, në të kundërtën mundë të thuhet si i tërë ky aktivitet nuk e ka seriozitetin e duhur. Pa një mbikëqyrje të gjitha fazave të veprimtarisë afariste, nuk mundë të sigurohet sukcesi. Pa mbikëqyrjen profesionale dhe të pa ndërprerë të rrjedhave ekonomiko-financiare, ndërmarrja nuk mundë të jetë e sigurt se do të realizoj planet e veta. Varësisht nga përgjigjet në pyetjet e bëra: QKA, KUSH, KU, PSE, SI, klasifikohen edhe llojet e mbikëqyrjeve. Këto mbikëqyrje emërtohen si kontroll, inspektim apo revizionim.

Marrë parasysh këto përkufizime mundë të thuhet se nocioni i mbikëqyrjes parakupton tërësinë e veprimeve dhe të mënyrave të veprimit për të konstatuar një gjendje në ndërmarrje ekonomike.

¹ . Dr.Hajrullah Gorani : “Kontrolli dhe revizioni”, UP, Prishtine 1998,f .9 .

Mbikëqyrja do të thotë se me zbatimin e metodave të pranuar të hetimit të konstatohen shmangiet eventuale nga normat dhe kriteret e parapara. Kur të konstatohen këto shmangie duhet të merren vendimet me kohë për mënjanimin e tyre kuptohet edhe te marrjes ne përgjithësi shkaktaret e këtyre shmangieve varësisht nga vëllimi dhe karakteri i tyre.

1.1. TRAJTAT E MBIKËQYRJES

Marre në përgjithësi mbikëqyrja mund të klasifikohet në dy grupe kryesore²:

a. Mbikëqyrja e brendshme dhe

b. Mbikëqyrja e jashtme

a. Mbikëqyrja e brendshme-e bëjnë organet përkatëse të formuar brenda në ndërmarrje Karakteristikë kryesore e kësaj mbikëqyrje është, se e njohin mirë veprimtarinë e ndërmarrjes, procesin e prodhimit, objektet, mjetet me te cilat disponon, mënyrën e organizimit të brendshëm, kuadrot e angazhuara etj. Pra, mendohet se këto organe e njohin më hollësi gjithë veprimtarinë afariste, andaj edhe pritet qe kjo mbikëqyrje me kohë ti hetojë shmangiet nga rregullat, normat dhe përgjithësitë kriteret e paraparë për veprimtarinë e ndërmarrjes. Nga këto organe pritet që me kohë të marrin masa përkatëse për mënjanimin e këtyre shmangieve.

b. Mbikëqyrja e jashtme-bëhet nga ana e organeve që veprojnë jashtë ndërmarrjes që janë të autorizuar me ligj për të mbikëqyrur veprimtarin afariste të saj. Mbikëqyrja e tyre është e mëvonshme, pasi të janë kryer veprimet e caktuara afariste. Prandaj thuhet se efekti i mbikëqyrjes së tyre ka karakter korrektues ndryshe prej atij të organeve të brendshme që ka karakter preventiv, parandalues. Organet e jashtme të mbikëqyrjes kanë për detyrë të bëjnë edhe hetimin e korrektësisë së veprimeve gjatë mbikëqyrjes së brendshme . Nëse ato janë bërë në përputhje me rregullat, normat dhe kriteret e parapara atëherë edhe organet e mbikëqyrjes së jashtme nuk do të kenë punë për korigjimet eventuale.

² Dr.Hajrullah Gorani:”Kontrolli dhe revizjoni”,UP,Prishtine 1998,f.10

Mbikëqyrja behët gjatë periudhave të ndryshme kohore. Varësisht nga koha kurë behet mund të kemi³:

- a. **Mbikëqyrje të përhershme ,**
- b. **Mbikëqyrje të kohëpaskohshme,**
- c. **Mbikëqyrje periodike (në periudha të caktuara),**
- d. **Mbikëqyrje paraprake,dhe**
- e. **Mbikëqyrje të mëvonshme**

a. Mbikëqyrja e përhershme –zbatohet më shumë në procesin e prodhimit dhe nëpër ato ndërmarrje ku shmangiet nga normat, kriteret apo kodet teknologjike mundë të kenë pasojë të rënda materiale, financiare apo në viktima njerëzish. Këtu, mbikëqyrja duhet të jetë e rreptë dhe e pa ndërprerë, do të thotë si një pasqyrë e qartë e gjithë asaj që ndodhe në ndërmarrje.

b. Mbikëqyrja e kohëpaskohshme-parakupton kontrollin që bëhet ad-hoc, sipas nevojës së paraqitur .Kështu gjatë veprimtarisë afariste, paraqitet nevoja për zbatimin e mbikëqyrjes lidhur më ndonjë dukuri të caktuar të shfaqur në ndërmarrje. Për të ndriçuar ketë dhe për ti mënjauare dëmet të cilat një dukuri e tillë do ti sjell ndërmarrjes, angazhohen organet profesionale të mbikëqyrjes që ti bëjnë hetimet e duhura.

c. Mbikëqyrja periodike-bëhet sipas një rregulli të caktuar .Kështu mundë të caktohet që çdo tre muaj të bëhet kontrolli i ndonjë veprimtarie të caktuar të ndërmarrjes. Karakteristika e kësaj mbikëqyrje është se ajo zbatohet rregullisht dhe në periudha të caktuara.

d. Mbikëqyrja paraprake-kjo mbikëqyrje ka karakterin parandalues dhe zbatohet sidomos gjatë fazës së përgatitjeve për ta filluar procesin e prodhimit Gjithashtu, kontrollonhet a janë siguruar mjetet e duhura nga burimet e përshtatshme për atë veprimtari. Me ketë lloj të mbikëqyrjes evitohen dëmet që mundë të ndodhin për shkak të përdorimit të mjeteve jocilësore apo të pamjaftueshme. Shpeshherë,investimet e

3 Dr. Hajrullah Gorani:"Kontrolli dhe revizjoni",UP,Prishtine 1998,f.11

pezulluara janë pasojë e mungesës së mbikëqyrjes paraprake me çka shkaktohet dalja e mjeteve jashtë funksionit dhe mungesa e tyre për veprimtari të rregullt.

e. Mbikëqyrja e mëvonshme-këtu kemi të bëjmë me një lloj të mbikëqyrjes përmes së cilës tentohet konstatimi i rregullsisë së veprimeve të kryera. Nëse konstatohen shkeljet e rregullave të normave e të kriterëve të përcaktuara më herët përmes mbikëqyrjes së mëvonshme ndërmerren masa për korrigjimin e tyre.

-II-

2. BANKAT DHE SISTEMI BANKAR NË KOSOVË

Kuptimi dhe definicioni i bankave, për tu përcaktuar me sakët koncepti i bankës dhe për tu formuluar definicioni sa me i afërt në kushtet bashkëkohore në të cilat punojnë bankat duhet të caktohen kriteret në bazë të cilave bankat dallohen nga ndërmarrjet prodhuese, tregtare dhe ato që merren më veprimtari shërbyese. Më parë bankat kanë qenë krijueset e vetme të likuiditetit dhe bartëse e funksionit depozitarë. Mirëpo me zhvillimin e ekonomisë bashkëkohore krijohen një mori organizatash financiare të cilat krahas me bankat luajnë rol të rëndësishëm në mobilizimin e mjeteve monetare dhe financimin e nevojave të ekonomisë .

Në vendet e zhvilluara ekzistojnë shumë institucione financiare private të cilat nuk mundë të quhen banka, prandaj duhet përcaktuar në mënyrë që të shihet dallimi në mes të bankave dhe organizatave të tjera financiare. Andaj mbi bankën mundë të japim këtë përkufizim: **Banka është një institucion i posaçëm financiarë i sistemit monetare-kreditor që merret më marrjen dhe dhënien e kredisë në mënyrë profesionale si dhe më ndërmjetimin në qarkullimin e pagesave të komiteteve.**

Ky definicion shpjegon nga aspekti teorik esencën e funksioneve të detyrave e të punëve të saja. Mendohet se definicionin më të plotë të bankës e ka dhënë zvicerani Dr. Felikx Somary në veprën e tij “ Bankpolitik ”e cila është botuar në Thubingen në vitin 1934. Sipas tij banka është një institucion ose ent, puna kryesore e së cilës është marrja e kredive në formë të parave.

Somary⁴ i qaset funksionit të bankës jo nga aspekti i dhënies së kredisë ose kryerjes së punëve të tjera bankare por nga aspekti i ngarkimit me borgj të bankës do të thotë nga mënyra e mobilizimit të mjeteve monetare .Esenca e konceptit bankë qëndron në marrjen dhe dhënien e kredive e cila përfshin si veprimtarin kryesore ,dy grupe themelore të punëve financiare të bankës.

a. Punët e krijimit të parave

⁴ Sabahudin Komoni:”Financat”,Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mesimore të KSA të Kosovës,Prishtinë,1985,f.124.

b. Punët e ndërmjetësimit financiare

a. Funkzioni i krijimit të parave- nënkupton emisionin e kartëmonedhave dhe krijimin e parave depozitave bankave .Funksioni i krijimit të parave ka edhe një kuptim më të gjerë ku përfshihet edhe krijimi i parave nga ana e Bankës Qendrore do të thotë krijimi i bazës monetare apo parasë primare. Esenca ekonomike e këtyre punëve është furnizimi i procesit të riprodhimit shoqërorë me sasi të nevojshme të parave. Kufirin e krijimit të parave e paraqet likuiditeti i sajë dhe faktori i multiplikimit kreditorë e monetare.

b. Funkzioni i ndërmjetësimit financiare –Konsiston në ndërmjetësimin në mes të sektorëve të ndryshëm (siç janë ekonomia ,shteti ,popullsia etj) të cilët kanë suficit financiare dhe sektorëve të cilët kanë deficit financiare. Ndërsa ky funksion përmban katër komponentë të pavarura:

- Grumbullimi i mjeteve disponuese në kuadër të një ekonomie kombëtare,
- Transformimi i strukturës së afatit të depozitave ,gjë që i mundëson bankës në bazë të depozitave me afat më të shkurtër të kthimit të jap kredi me afat më të gjatë të kthimit,
- Krijimi i metodave sa më efikase e racionale të grumbullimit të lejimit të mjeteve monetare si nga aspekti i stimulimit të kursimit dhe i sigurimit të hyrjes së mjeteve ose nga aspekti i kualitetit do të thotë i strukturës së afatit dhe i shkalles së likuiditetit të mjeteve ,ashtu edhe nga aspekti i alokacionit ekonomikë të plasmanëve.
- Sigurimi i kocentrimit optimal të rrjedhave monetare më qellim të tejkalimit të kufizimeve territoriale, kohore e kufizimeve të destinimit. Funkzioni i ndërmjetësimit është pothuajse funksion bazik i bankave, ngase është prezentë në gati tërë afarizmin bankar dhe i përshkon të gjitha punët ,instrumentet, tekniken dhe praktiken e bankave Këtu kemi të bëjmë me punët e burimeve të mjeteve ,do të thotë me punët e grumbullimit të mjeteve dhe të kocentrimit të mjeteve monetare si dhe më punët e plasmanëve që me një fjalë quhen punët kreditorë të bankës. Vetëm funksioni i krijimit të parave si dhe punët e depozitave dhe plotësimi i nevojave të ekonomisë për mjete

monetare afatshkurtër e afatgjatë shtron si detyrë para bankës që aktivitetin e vetë ta harmonizoj me qëllimet dhe detyrat e politikës ekonomike të një vendi.

2.1. Llojet e bankave

Në zhvillimin e bankave bashkëkohore kanë ndikuar dhe ndikojnë ligjet e njëjta të afarizmit racionale, ekonomik, dhe rentabilitet në të cilat bazohet sistemi i tërësishëm bashkëkohor i afarizmit. Në veprimtarin dhe organizimin e bankave, ato ligje ndikojnë me një forcë të veçante dhe kërkojnë nga ajo që tu përshtatet nevojave të ekonomisë dhe të tregut të parave.

Ndërlíkushmëria dhe llojshmëria e aktiviteteve ekonomike dhe dinamika e tregut bashkëkohor të vendit dhe të jashtëm, detyron bankën që të jetë në trend dhe në gjendje të tillë dhe që afarizmin e sajë ta harmonizoj me realizimin e rentabilitetit maksimal dhe të sigurisë në afarizmin e sajë.

Kriteri më i përhapur është ai i cili i klasifikon bankat në bazë të sajë se si i siguron ajo mjetet e nevojshme financiare në bazë të këtij kriteri bankat i ndajmë në:

- Banka imituese (qendrore)
- Banka komerciale(depozitarë)
- Banka afariste
- Banka investime
- Banka te specializuara ose të degëve
- Banka universale
- Banka hipotekare
- Banka regjionale dhe banka për zhvillim
- Banka multinacionale
- Banka kursimore

2.2. Banka komerciale (depozitarë)

Bankat komerciale janë banka që bëjnë kreditimin afat shkurtër të prodhimit dhe konsumit .Këto banka mjetet i krijojnë prej depozitave të kursimit të popullsisë .Në bazë të burimeve të mjeteve, që janë afatshkurtra japin kredi më afat të shkurtër për blerjen e mallrave dhe për këtë arsye quhen banka komerciale. Bankat komerciale paraqesin bankat më të shumta dhe më të përhapura në bote .Ato janë bazë e sistemit të ndërmjetësisë financiare sepse me punët e tyre i mobilizojnë depozitat dhe pastaj lejojnë kredi për plotësimin e nevojave të ekonomisë. Duke bërë kreditimin afatshkurtër ato njëkohësisht bëjnë emisionin e parave, duke ndikuar kështu në ndryshimin e masës monetare dhe likuiditetin e vendit.

Këto banka në shumë vende janë bërë kanali kryesor i krijimit të parave dhe likuiditetit. Dinamika e ecurive ekonomike bashkëkohore shtron detyra gjithnjë më të ndërlikuara ndaj bankave komerciale, por njëkohësisht i detyron ato që ti përmbahen rreptësishtë parimet e likuiditetit dhe të sigurisë së plasmanëve si dhe parimit të rentabilitetit. Nga ana tjetër konkurrenca gjithnjë më e madhe në tregun e parave dhe të kapitalit e detyron bankën që të ketë një politik sa më elastike kreditore ,që nënkupton përcjelljen e vazhdueshme të ecurive ekonomike dhe gjendjen në tregun e vendit dhe tregjet e jashtme dhe njohjen sa më të madhe të afarizmit të secilit komitet të bankës.

2.3. Sistemi bankare në Kosove

Sistemi bankare në Kosove përbehet nga dy nivele:

- a. Autoriteti Bankar
- b. Bankat komerciale

a. Autoriteti bankar ushtron funksionin e Bankës Qendrore, më përjashtim se nuk ka të drejtën e imitimit të parasë. Në Kosovë aktualisht si valutë zyrtare është € (Euro), imitimi i së cilës kontrollohet nga Banka Qendrore Evropiane.

b. Bankat komerciale si veprimtari themelore të tyre kanë kreditimin e ekonomisë. Në Kosovë aktualisht veprojnë këto banka komerciale: Banka Ekonomike, Banka e Re

e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Popullore, Banka Private për Biznes, NLB Banka, ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bankë, TEB Banka etj.

Të gjitha këto Banka kanë selinë në Prishtinë dhe njësitë e tyre në qendrat dhe qytete e tjera të Kosovës.

-III-

3. KONTROLLI I MARREDHENJEVE ME BANKA

Varësisht nga sistemi ekonomik-shoqëror, si dhe nga zhvillimi ekonomik i vendit, rregullohet edhe sistemi bankar. Zakonisht, konstatohen bankat popullore (Bankat kombëtare ose bankat e shtetit) dhe bankat afariste.

Bankat popullore, zakonisht janë banka emetuese të cilat edhe propozojnë politiken kreditore e monetare, si dhe politiken revizore të një vendi.

Bankat afariste janë orientuar për bashkëpunimin me ndërmarrjet ekonomike, mirëpo kur e do nevoja dhe kur e shohin interesin e tyre, bashkëpunojnë edhe me organizata jo ekonomike dhe me një nejësi të ndryshme administrative.

Kontrolli i veprimtarisë bankare nënkupton kontrollin e dokumentacionit bankar si dhe krahasimet me ligjet dhe dispozita ligjore e aktet e tjera nënligjore, si dhe me aktet normative të ndërmarrjes që e rregullojnë këtë materie. Këtu kontrollohet mënyra e grumbullimit të mjeteve të bankës, plasmani i tyre kushte të plasmanit, normat e kamatës, afatet dhe kushtet e tjera⁵.

Gjithashtu, kontrolli ka për detyrë të konstatoj a i përmbahen palët kontraktuese (banka dhe klientët) kontratave të lidhura a bëhet pagesa e rregullt e detyrimeve të skaduar e derdhjeve të kësteve të plasmanëve në llogarit përkatëse të bankës etj.

⁵ Dr. Hajrulla Gorani : “Kontrolli dhe Revisioni”, UP, Prishtine 1998, f.26.

-IV-

4. REVIZIONI I RAPORTEVE FINANCIARE I BANKAVE

AFARISTE

Revizioni i bankave komerciale, Bankat luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomin e një vendi. Ato mbledhin kursimet e publikut, japin mjetet e pagesës për mallrat dhe shërbimet dhe financojnë projektet për zhvillimin e prodhimit dhe të tregtisë. Për të kryer këto funksione me siguri dhe efektivitetet, bankat duhet të fitojnë besimin e publikut dhe organizatave ekonomike me të cilat ato punojnë.

Bankat komerciale janë subjekt i mbikëqyrjes së gjendjes së tyre financiare nga Bankat Qendrore dhe nga agjencitë të tjera zyrtare. Duke pasur parasysh kompleksitetin e rritjes së veprimtarisë bankare në shumë aspekte mbikëqyrësit bankar dhe auditorit e jashtëm përballen me të njëjtat sfida dhe roli i tyre gjithnjë në rritje është konsideruar si plotësues të njeri tjetrit.

Komenti i Standardeve Ndërkombëtare të Revizionit dhe Komiteti i Mbikëqyrësve të Bazelit janë të një vendimi, që mirëkuptimi dhe komunikimi më i madh reciprok në mes tyre, përmirësojnë efektivitetin e punës së tyre përkatëse dhe do të kenë dobi reciproke.⁶

Menaxhmenti i bankës, autoritetet mbikëqyrëse dhe revizoret e jashtëm kanë rol dhe përgjegjësi në lidhje me kryerjen e kujdesshme të veprimtarisë bankare. Rolet dhe përgjegjësit e secilit prej tyre në vendet e ndryshme, ndryshojnë për dy arsye: nga ligji dhe nga tradita.

4.1 Përgjegjësia e Menaxhmentit të Bankës

Përgjegjësia kryesore në drejtimin e veprimtarisë së një banke bie mbi këshillin e menaxhmentit dhe drejtuesve të caktuar, të cilët janë emërtuar prej tij. Kjo përgjegjësi përfshin dhënien e sigurisë:

⁶ Dr. Hysen Ismajli: “Kontrolli dhe Revizion”, (ligjeratat e autorizuara) Prishtine, 2004, f.13

- Se personave të cilëve iu është besuar detyra bankare, ata janë profesioniste kompetent dhe se në postet kyçe ka ekipe me eksperience të mjaftueshme.
- Se ekzistojnë dhe funksionojnë sisteme të përshtatshëm të kontrollit
- Se veprimtaria e bankës ushtrohet duke i kushtuar vëmendje parimit të kujdesit, duke përfshi sigurinë, se janë krijuar rezervat e mjaftueshme për humbjet.
- Se mbikëqyren direktivat statusore dhe rregulluese, duke përfshi direktivat për aftësinë pagese dhe likuidimit.
- Se interesat e aksionareve, depozituesve dhe kreditorëve tjerë mbrohen siç duhen.

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhjen më legjislacionin kombëtar; këto pasqyra duhet të japin një pamje “të vërtetë dhe të sinqerte” gjendjen financiare të bankës dhe rezultatet e veprimtareve të saj në përputhje me parimet kontabël, përgjithësisht të pranuar që zbatohen për bankat.⁷

Për vendosjen dhe veprimin më efikasitet të funksionimit të auditimit të brendshëm në bankë, është përgjegjës menaxhmenti dhe mbanë përgjegjësi që funksioni i auditimit të brendshëm të realizohet nga një ekip i zgjedhur njerëzish me aftësitë dhe kompetencat teknike përkatëse.

4.2. Roli i mbikëqyrësit bankar

Roli i zakonshëm i mbikëqyrësit është të mbroj interesat e depozituesve të bankës. Në praktike, ky rol po kombinohet gjithnjë e me shumë me një detyrë me të gjerë, atë të mbrojtjes së sigurisë dhe stabilitetit të sistemit bankar. Si fuqi kryesore mbi të cilën mbështetet autoriteti i mbikëqyrësve, bazohet në të drejtën për të licencuar kryerjen e veprimtarisë bankare dhe për të hequr licencat e tilla për të përfituar dhe mbajtur këtë licencë, duhet të përmbushen disa kërkesa kujdesi. Këto kërkesa ndryshojnë nga një vend në tjetrin për sa i përket veçantive të tyre. Kërkesat bazë për autorizim, gjendjen përgjithësisht në shumicën e sistemeve të mbikëqyrjes⁸

⁷ Dr. Hysen Ismajli: “Kontrolli dhe revizioni”, (ligjerata te autorizuar) Prishtine, 2004, f. 14

⁸ Dr. Hysen Ismajli : “Kontrolli dhe revizioni”, (ligjërata te autorizuar) Prishtine, 2004, f .14

- bankat duhet të ketë kapitalin e mjaftueshëm për të përballuar rreziqet që vijnë nga natyra dhe përmasat e veprimtarisë së saj

- banka duhet të ketë likuiditet të mjaftueshëm për ti bërë balle daljes së fondeve.

Në çoftë se një bankë nuk respekton kushtet dhe kërkesat për autorizim, autoritet mbikëqyrës ka të drejtën për të konsideruar heqjen e licencës. Mirëpo ,heqja e licencës është sanksion i fundit sepse kjo e mbyll veprimtarin bankare.

Bankat janë subjekt i rreziqeve të shumëllojshme. Më i rëndësishmi prej tyre është rreziku i kredisë, mbikëqyrësi bankar nuk është në rolin që të drejtoje politikat e kreditimit të bankave, por ai është i interesuar të shoh, se bankat kanë procedura efektive të shqyrtimit të kredisë, të cilat zbatohen vazhdimisht. Rendësi të madhe për mbikëqyrësit ka edhe vlerësimi i saktë dhe i kujdesshëm i aktiveve që paraqesin një nga përcaktuesit me të rëndësishëm të stabilitetit të bankës dhe është vështirë për tu vlerësuar cilësia e tyre (aktiveve). Mbikëqyrësi ka ndikim direkt në përcaktimin e shumës së aktiveve në to të mbajtura nga banka dhe shumës së kapitaleve të veta të aksionareve (kapitali + fitime të mbajtura).

Mbikëqyrësit i japin rendësi të konsiderueshme nevojës së bankave për të pasur një strukturë organizative të përcaktuar mirë dhe për të vepruar me informacione efikase dhe sisteme kontrolli për veprimet kundër rrezikut, kështu interesohen të japin siguri se cilësia e menaxhmentit është e përshtatshme për natyrën dhe shtrirjen e veprimtarisë së bankave.

Në përputhje me natyrën e rregullave të mbikëqyrjes, metodat e zbatuara për tu siguruar nëse rregullat ndiqen, ndryshojnë nga njeri vend në tjetrin. Në thelb ka dy teknika, që përdoren:

- a. ekzaminimet në vend; dhe
- b. mbledhja dhe interpretimi i raporteve periodike dhe të dhënave të tjera statistikore.

Ekzaminimi në vend mobilizon shumë burimeve të mbikëqyrjes se si rregull, nuk mbulojnë vetëm një pjesë të vogël të veprimtarive të institucionit. Në disa vende teknikat e ekzaminimit tentojnë të përqendrohen në cilësinë e aktiveve nga huat e dhëna

dhe në dokumentacionin që mbështeten ato si dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Ekzaminimi i raporteve statistikore kushton me pak dhe shpenzimet shpërndahen midis bankave.

Ky ekzaminim i raporteve i cili bëhet në intervaleve të rregullta i lejon mbikëqyrësit të vëzhgojë zhvillimet e veprimtarive në mënyrën më të vazhdueshme periodike se sa në rastin e inspektimit në vend.

4.3 Roli i revizorit të jashtëm të bankës

Si objektiv kryesor i revizionit të bankës nga një revizore i jashtëm është ti mundësoj revizorit që ta shpreh opinionin, nëse pasqyrat financiare të publikuara të bankës japin “një pamje të vërtet e të sinqertë” të pozicionit financiar të bankës dhe rezultateve të veprimtarive të sajë për periudhën për të cilën janë përgatitur pasqyrat.

Për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare ,auditori kërkon të arrije një siguri që informacionet në përmbajtje të dokumenteve kontabël të paraqitura dhe të dhënat e tjera bazë janë të besueshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur përgatitjen e pasqyrave financiare. Për këtë qëllim auditori ,ekzaminon dhe vlerëson sistemit kontabël dhe kontrollet e brendshme mbi të cilët ai dëshiron të mbështetet. Auditori jashtëm për kryerjen e auditimit të një banke mban parasysh se disa karakteristika të bankave të shkaktojnë probleme të veçanta .

- Bankat kanë në ruajtje sasi të mëdha parash (para në dorë dhe instrumente të negociueshme), ruajtja fizike e të cilave duhet siguruare.
- Kjo zbatohet si në ruajtjen ashtu edhe në transferimin e parave dhe i bën bankat të ekspozuara ndaj shpërdorimeve ose mashtrimeve.
- Banka angazhohen në transaksione të volumeve të mëdha dhe të shumëllojshme ,në aspektin numerik dhe të vlerës së tyre.
- Në shumicën e vendeve bankat veprojnë normalisht nëpër mjet një rrjeti të gjer degësh e agjencish të shpërndara duke kaluarë kufijtë kombëtare .

- Bankat zakonisht ndërmarrin angazhime të mëdha pa ndonjë transfero të fondeve. Këto elemente janë quajtur elemente jashtë bilancit ;të cilat mund të mos përfshinë regjistrime kontabël dhe si rrjedhojë ,nëse ata nuk janë regjistruara mund të jetë vështir të zbulohen⁹.

Auditori planifikon dhe drejton punën e tij në mënyrë të tillë,që nga auditimi të pritët në mënyrë të arsyeshme zbulimi i deklarimeve të parregullta në pasqyrat financiare të bankës. Vlerësimi se çfarë është materiali,është qështje e gjykimit profesional të auditorit por ndikohet nga mendimi i auditimit mbi nevojat e përdoruesit të pasqyrave financiare të bankës dhe nga vlerësimi që ai i bënë rrezikut se deklaratimet e parregullta materiale në informacionet e tilla mund të mbeten të pa zbuluara dhe me pasoja përkatëse .Niveli i materialit i përdorur nga auditori për raportin e tij mbi pasqyrat financiare të bankës mund të jetë i ndryshëm nga niveli kurë bënë raporte të veçanta për mbikëqyrësin e bankës.

Për të formuar opinionin e tij për pasqyrat financiare, auditori zbaton procedurat e posaçme për të zotëruare siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë paraqiture siç duhet në të gjitha aspektet materiale .

Ekziston rreziku i pashmangshëm që edhe disa anomali materiale të mbeten të pazbuluara. Rreziku i mos zbulimit të anomalive materiale që rezultojnë nga gabimi sepse mashtrimi zakonisht përfshin veprime të posaçme për të fshehure atë e tilla si marrëveshjet e fshehta, falsifikime ,mos regjistrimi i qëllimshëm i transaksioneve ose paraqitjet e parregullta te bëra qëllimisht për auditorët .

Kurë auditori zbulon një gabim që ka ndikim materiale në pasqyrat financiare sidomos në përdorimin e politikave të papërshtatshme kontabël apo një vlerësim të aktiveve me të cilin ai nuk është dakord ,ose një mungesë e informacioneve thelbësore,auditori kërkon ndryshimin e pasqyrave financiare për të korrigjuare gabimin

Si pjesë plotësuese të angazhimit të tij auditori zakonisht i dërgon menaxhmentit të bankës një letër. Kjo letër përmban komente mbi qeshje të tilla si mungesat në kontrollin e brendshëm ose gabimet ose mangësitë, qe kanë tërhequre

⁹ Dr .Hysen Ismajli :”Kontrolli dhe revision ”,(ligjërata te autorizuara)Prishtinë ,2004,f.17

vëmendjen e auditorit gjatë auditimit por që nuk kërkojnë rezervë në raportin e tij të auditimit sepse janë korrigjuar gabimet në pasqyrat financiare ose nuk janë materiale në përmbajtje.

4.4 Marrëdhëniet mes mbikëqyrësve dhe revizorëve

të jashtëm

Në shumë aspekte, mbikëqyrësi dhe edituesi kanë interesa plotësuese për të njëjtat çështje megjithëse orientimi i interesimit të tyre mund të jetë i ndryshëm kështu: mbikëqyrësi interesohet kryesisht mbi stabilitetin e bankës, me qëllim që të mbrojë interesat e depozituesve. Ndërsa auditori interesohet kryesisht mbi raportin rreth gjendjen financiare të bankës dhe mbi rezultatet e veprimtarive të saj.

Mbikëqyrësi interesohet për një sistem të kontrollit të brendshëm efikas, si bazë për menaxhimin e sigurve e të kujdesshëm të bankës. Mbikëqyrësi interesohet për ekzistencën e sistemit kontabël përkatës, ndërsa auditori interesohet për të zotëruar siguri se regjistrat kontabël prej nga përgatiten pasqyrat financiare janë mbajtur siç duhet.

Ka shumë fusha, ku puna e mbikëqyrësit dhe e auditorit janë në dobi të njëra tjetrës. Raporti për menaxhimin dhe raportet e formës së gjatë, hartuar nga auditori e pajisin mbikëqyrësin dhe analiza të vlefshme mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë së bankës.

Mund të ketë rrethana kur auditori ose mbikëqyrësi vënë në zotërim informacione të rëndësishme, të cilat nuk merren domosdoshmërisht nga pala tjetër por që janë të nevojshme të njihen prej saj. Rrethana të tilla mund të jenë veçanërisht:¹⁰

- kur auditori vë re fakte, të cilët në rrezik ekzistencën e bankës
- kur qoftë auditori, qoftë mbikëqyrësi zbulojnë një mashtrim në nivelin e drejtuesve të lartë
- kur auditori vendos të japë dorëheqjen nga auditivi para mbarimit të mandatit.

¹⁰ .Dr.Hysen Ismajli “Kontrolli dhe revizjoni” ,(ligjerata tee autorizuar)Prishtine,2004f.19

Mbikëqyrësi ka interes të dukshëm për të siguruar standarde të larta të auditivit të bankës.

Për këtë ai kërkon të mbahen kontakte të ngushta me organizmat profesional të auditivit. Në disa vende mbikëqyrësit kanë fuqi ligjore për emërimin e auditorëve p.sh e drejta për të miratuar ose hequr dhe e drejta për të kontraktuar një auditim të pavarur.

Përgjegjësia bazë për pajisjen e mbikëqyrësit me informacione të plota dhe të sakta duhet ti mbetet menaxhmentit të bankës. Roli i auditorit varet nga natyra e mjedisit mbikëqyrës kombëtar p.sh nëse një mënyrë veprimi ndiqet nga mbikëqyrësi, me një inspektim të vazhdueshëm e rigoroz,ndihma që mund ti kërkohet auditorit, normalisht është minimale. Menaxhmenti i bankës siç i paraqiten ato inspektimit,ose nëse burimet e mbikëqyrjes janë të kufizuara,mbikëqyrësi përfiton nga ndihma që ofron auditori në dhënien e opinionit të tij mbi besueshmërinë e informacionit të zotëruar. Shumë autoritete mbikëqyrje që praktikojnë inspektimin në vend, për këtë arsye janë të detyruara të mbështeten më shumë mbi raportimet që u paraqiten dhe tu drejtohen auditorëve për ndihmë në fusha ku aftësitë e tyre janë veçanërisht të spikatura.

4.5. Procedura e revizionit të një banke

Objektivat e revizionimit dhe procesi i revizionimit

SNA 200:Objektivat dhe Parimet Kryesore qe Udhëheqin Auditimin e Pasqyrave Financiare deklaron:

- Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti japë mundësinë auditorit të shpreh një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitë në të gjitha aspektet materiale ,në përputhje me një kuadër të raportimit financiarë.
- Objektivi themelore i auditimit të një banke është pra të japë një opinion të bazuara në SNA ose në standardet dhe praktikat përkatëse kombëtare të vendosura brenda vendit mbi pasqyrat financiare vjetore të bankës të cilat përgatiten në përputhje me SKN¹¹.

¹¹ .Dr.Hysen Ismajli: ”Kontrolli dhe revizioni “,(ligjërata te autorizuar)Prishtin,2004,f.20

Procesi

Auditimi që kryhet për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare të bankës, ndahen në disa faza të dalluara sikurse përshkruhet në SKN.

Paraqitja skematike e këtyre fazave është si vijon:

Përcaktimi i kushteve të Angazhimit

Planifikimi

- marrja e njohurive mbi klientin
- përpunimi i një plani të përgjithshëm
- koordinimi i punës që do të kryhet

Vendosja e shkalles se mbështetjes

ne kontrollin e brendshëm

- identifikimi, dokumentimi dhe testimi i procedurave të kontrollit
- konsiderimi i ndikimit të faktorëve të mjedisit
- përcaktimi i natyrës, qëllimit dhe shtrirjes së procedurave thelbësore të kërkuara

Kryerja e procedurave thelbësore

Raportimi i revizionimit mbi pasqyrat financiare

Përcaktimi i kushteve të angazhimit

Sipas SKN 210” Kushtet e Angazhimeve të Auditimit”

Letrat e angazhimit dokumenton dhe konfirmon pranimin nga ana e auditorit përgjegjësit e tij ndaj klientit dhe formës së raportit .

Për të kryer angazhimin e auditorit i nevojitet të vlerësoj aftësitë dhe kompetencat e veta dhe të ekipit të tij .Për një vlerësim të tillë, auditori konsideron faktorët që vijnë:

- Njohuri solide për një ekspertizë të mjaftueshme në të gjitha aspektet e veprimtarisë bankare
- Mjaftueshmëria e njohurive të tij për sistemet kompjuterike të informacionit dhe të sistemeve të transformimit elektronik të fondeve të përdorura nga banka.
- Mjaftueshmëria e burimeve dhe marrëveshja me zyrat e tjera për të cilat shtrihen jashtë kufijve kombëtare.

Planifikimi i revizionimit

Sipas SNR 300 "Planifikimi" parasheh:

Auditori planifikon punën e auditorit në mënyrë që auditori të kryhet efektivisht. Planet bëhen për të realizuarën:

- zotimin e njohurive të mjaftueshme mbi veprimtarin e klientit dhe një kuptueshmëri të mjaftueshme të sistemit të kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm,
- vlerësimin e nivelit të rrezikut të auditorit
- përcaktimin dhe programimin e natyrës ,kohëzgjatjes dhe shtrirjes së procedurave të auditimit që do të kryhen etj.

Marrja e njohurive mbi klientin

Marrja e njohurive mbi veprimtarin e bankës kërkon që auditorët të kuptojnë:

- ambientin ekonomik dhe rregullator mbi zotërues të secilit vend ,ku është vendosur banka ;
- kushtet e tregut që ekzistojnë në secilin sektor ku vepron banka.

Koordinimi i punës që do të kryhet

Për shkak të përmasave dhe shpërndarjes gjeografike të shumicës së bankave koordinimi i punës që do të kryhet është i rëndësishëm për arritjen e një auditorit të mirë.

Puna që do të kryhet nga:

- **Bashkëpunëtorët e ndryshëm të auditorit**
- **Zyra të tjera të agjencionit të auditorit**
- **Agjencionet e tjera të auditorëve**
- Përdorimi i punës së auditorit të brendshëm
- Datat në të cilat kërkohet ti raportohet aksionareve dhe auditorëve mbikëqyrës .

Nevoja për të marr analiza të veçanta dhe dokumente të tjera që do të përgatiten nga menaxhmenti i bankës.

Rreziqet e produkteve të shërbimit

Rreziku me i spikatur i produktit dhe i shërbimit në bankë është rreziku i kredisë ,i cili zakonisht paraqitet kur një klient ose pale nuk i kryen obligimet ndaj bankës në vlerën e plot të kredisë apo vonesën në kohë.

Rreziku i kredisë përfshin gjithashtu:

- **Rreziku i lidhure me vendin ose me transferimin**-rreziku kur klientët ose palët e huaja nuk i shlyejnë obligimet e tyre për shkak të ngjarjeve ekonomike ,politike ose sociale në vendin e huaj dhe që nuk varen nga vullneti i klientit ose palës së huaj.

- **Rreziku i zëvendësimit** –rreziku kur një klient ose pale nuk përmbushë kushtet e kontratës. Kjo krijon nevojën për të zëvendësuar transaksionet e pa përmbushura me një çmim tjetër aktuale të tregut.

- **Rreziku i mos likuidimit**-rreziku qe banka te përmbushë detyrimin e saja në kohën kur klienti nuk e kryen pagesën në kohën e paraparë .

Për ti bërë ballë rrezikut të kredisë ,bankat ndërmarrin masa ,të cilat i kushtohen aspekteve të ndryshme të funksionit të kredisë të cilat janë:

- **-procedurat e fillimit të kredisë dhe pagesat,**
- **-ndjekjen,**
- **-mbledhjen dhe**
- **-shqyrtimin dhe vlerësimin periodik.**

Rreziqe te tjera te produktit dhe shërbimet bankare përfshijnë:

Rrezikun e përqindjes së interesit –rreziku i humbjeve që vinë nga luhatjet e përqindjeve të interesit . Kjo përfshin dy elemente :

- rreziku i të ardhurave që është i humbjes që vjen kur lëvizjet e përqindjes së huamarrjes dhe
- huadhënies nuk janë saktësisht të sinkronizuara,

Rreziku i investimit që është rreziku i humbjes që vjen nga një ndryshim në vlerën e letrave me vlere,me të ardhura fikse si rezultat i ndryshimit të përqindjes së interesit

- **Rreziku i likuiditetit**-vjen nga rasti kur banka nuk ka mjete të mjaftueshme kur nuk ka mjete për ti përmbushure obligimet e saja.
- **Rreziku i valutës** –vjen nga lëvizjet e kurseve të këmbimit të zbatueshme për aktivet,obligimet dhe të drejtat në valutë të huaj.
- **Rreziku i tregut**-vjen nga lëvizjet në treg të investimeve në letra me vlerë.
- **Rreziku i ruajtjes në besim**-vjen nga faktorë të tille si mos mbajtja në ruajtje të sigurt.

Mbështetja në kontrollin e brendshëm

Për të formuar opinionin e tij të auditivit, auditusi përgjithësisht nuk mundë të mbështetet vetëm në rezultatet e testeve të tij thelbësore ,për shkak të :

- **Sasi të madhe të transaksioneve që regjistrohen nga bankat**
- **Mënyrës më të cilën janë regjistruare nga bankat**
- **Shpërndarjes gjeografike të veprimeve bankare dhe**
- **Shtrirjes së përdorimit të sistemeve të SKI dhe TEF.**

Prandaj në shumicën e rasteve auditorit i nevojitet të vendose mbështetje të rëndësishme në sistemin bankar të kontrollit të brendshëm.

Kjo paraqet fazën e par të punës se revizorit ku benë hetimin dhe vlerësimin e punës së kontrollit të brendshëm.

Hetimet për efikasitetin e kontrollit të brendshëm bëhen me anën e pyetësorëve të standardizuar.

Pyetëtorët standard janë të përpiluara në atë mënyre që përgjigjet të reduktohen vetëm në “po”ose”jo”.

Në ato raste nuk përdoren pyetëtorët standard për hetimin e kontrollit të brendshëm ,bëhet përshkrimi i ngjarjeve afariste ,të kontabilitetit dhe të ndarjes së detyrave dhe të përgjegjësisë . Revizori duhet të japë vlerësimin e vet për çdo pjese të përshkruar të kontrollit të brendshëm .

Vlerësimi behet duke i shënuar vlerësimet “**mirë**”
“**mjaftueshëm**”,ose”**dobët**”.

Identifikimi ,dokumentimi dhe testimi i procedurave te kontrollit

Sipas SNR 400”**Vlerësimet e Rrezikut dhe Kontrolli i Brendshëm**”parashtrohen katër objektiva të kontrollit të brendshëm :

- Transaksionet ekzekutohen në përputhje me autorizime të veçante ose të përgjithshme të Menaxhmentit;
- Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet e tjera regjistrohen menjëherë në shumën e sakët ,në llogarinë përkatëse dhe në periudhën kontabël,për të lejuar kështu përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me një kuadër të përcaktuare të raportimit financiare;
- Hyrja në aktive lejohet vetëm në përputhje me autorizimet e menaxhmentit dhe
- Aktivitetet e regjistruara krahasohen me aktivet ekzistuese në intervale të arsyeshme dhe ndërmerren veprimet e përshtatshme në lidhje me diferencat.

Materialiteti dhe rreziku i revizionimit

Materjaliteti

Ne vlerësimin e mate realitetit auditorit duhet të ketë parasysh:

- Për shkak të angazhimeve të mëdha edhe gabimet relativisht të vogla , munde të kenë ndikim të rëndësishëm në llogarinë e rezultatit dhe në kapitalet e veta megjithëse nuk kanë ndikim të rëndësishëm në vete dhe në bilancin.

- Përderisa fitimet në to të bankës janë të ulëta në krahasim me totalin e aktives dhe pasives si dhe angazhimet jashtë bilancit, gabimet që lidhen vetëm me aktiven , pasiven munde të jene pak të rendësi sheme, se ato qe lidhen më deklarimin e fitimeve,

- Bankat shpeshherë janë subjekt i kërkesave rregull aktive të tilla si kërkesa për të mbajture nivel minimal të kapitalit.

Rreziku i Auditimit

Tri komponentët e rrezikut të auditorit janë:

- Rreziku i vetvetishëm – in herën (rreziku se mund te ndodhin gabime materiale)
- Rreziku i kontrollit (rreziku se sistemi i kontrollit te brendshëm të bankës nuk i parandalon ose korrigjon gabimet e tilla) dhe
- Rreziku i zbulimit– deduksionit (rreziku se ndonjë gabim material i mbetur nuk zbulohet nga auditorët)

Kryerja e procedurave themelore

Shtirja e procedurave themelore, bazohet në vlerësimin e bere nga . auditorit

Sikurse parashtrohet ne SNA 500 “Faktet e auditorit “:Procedurat themelore nënkuptojnë testet e kryera për të zotëruar fakte auditorit për të zbuluar anomalit materiale në pasqyrat financiare.

Pohimet e pasqyrave financiare janë pohime të menaxhmentit të shprehura ose të nënkuptuara që trupëzohen në pasqyrat financiare, ato mund të klasifikohen si vijon:

Ekzistenca

-një aktiv ose një detyrim ekziston në një datë të dhënë

Te drejtat dhe detyrimet

-një aktiv ose një detyrim i përket entitetit në një date të dhëne

Ndodhja dhe përkatësia

-një transaksionet ose një ngjarje ka ndodhure dhe qe i përket entitetit gjatë ushtrimit

Plotësia

-nuk ka aktive ,detyrimet ,transaksionet ose ngjarje të pa regjistruara ,ose elemente të padeklaruara

Vlerësimi

-një aktiv ose detyrim është regjistruar me vlerën e duhur

Matja

-një transaksion ose ngjarje është regjistruar më shumën e duhurë dhe e ardhura ose shpenzimi i është lidhurë periudhës së duhur

Paraqitja dhe informacionet e dhëna

-një element paraqitet, klasifikohet dhe përshkruhet në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiarë

Teknikat e auditivit

Për tu referuar pohimeve të diskutuara më sipër, auditori gjykon se procedurat e rëndësishme për ekzaminimin e llogarive të bankës janë:

- -procedurat analitike
- -inspektimi dhe
- -kërkesa për informacione dhe konfirmimet.

- Procedurat analitike- përdorimi i teknikave procedurale analitike

tregon se është procedurë e rëndësishme dhe e dobishme për arsye që vijnë:

Normalisht dy elementet më të rëndësishme në përcaktimin e rezultateve të bakës janë të ardhurat nga interesat dhe shpenzimet për interesat. Ky ekzaminim zakonisht behët në lidhje me kategoritë e aktiveve dhe detyrimeve të përdorura nga banka në drejtimin e veprimtarisë së saj.

Shqyrtimi analitik i përbërjes së llogarisë është metodë e rëndësishme,me anë të së cilës auditori zbulon disa probleme me interes për auditorin të tillë si përqendrim i tepruar i rreziqeve nën një sektor ose një zone gjeografike të veçante dhe ekspozimi i mundshëm ndaj rreziqeve të përqindjeve të interesit të valutave dhe të maturitetit.

Ne shumicën e vendeve ekzistojnë shume informacione financiare dhe statistikore që dalin nga autoritetet të mbikëqyrjes dhe nga burime të tjera të cilat që dalin nga

autoritetet te mbikëqyrjes dhe nga burime të tjera të cilat auditori i përdor për të kryer shqyrtimin analitik te thelluar te tendencave dhe analiza të bëra nga profesione te ngjashme.

- **Inspektimi**-sikurse përcaktohet në SNA 500 “Faktet e auditivit” inspektimi konsiston në ekzaminimin nga auditori të regjistrimeve të dokumenteve ose aktiveve fizike. Auditori inspekton me qëllim që:

- të sigurohet për ekzistencën fizike të aktiveve të negociueshme të mbajtura nga banka dhe
- të verifikojë se ai vetë zotëron kuptueshmërinë e mjaftueshme të kushteve dhe afateve të marrëveshjeve.

Shembuj të fushave ku përdoret inspektimi, si një teknikë auditivi janë:

- sendet e çmuara,
- letrat me vlerë
- marrëveshjet e huas
- marrëveshjet e angazhimit.

- **Kërkesa për informacion dhe konfirmimi**-konsiston në kërkesën e informacionit nga personat që kanë dijeni brenda dhe jashtë bankës.

Auditori kërkon informacionin dhe konfirmime me qëllim që:

- të mbledhë evidencë për funksionimin e kontrollit të brendshëm
- të mbledhë fakte mbi konfirmimin nga ana e klientëve dhe korrespondentët e bankës të shumave, afateve dhe kushteve të disa transaksioneve dhe të marrë informacione që nga regjistrimet kontabël të bankës nuk janë të disponueshme menjëherë.

Për shkak të ekzistencës në bankë të sasive të mëdha të aktive dhe detyrimeve monetare dhe të angazhimeve jashtë bilancit, konfirmimi i tepricave shpesh është metoda më e sigurve dhe më praktike për të përcaktuar ekzistencën dhe plotësin e shumave të aktiveve dhe të detyrimeve që paraqiten në pasqyrat financiare.

-V-

5. PËRPILIMI I RAPORTIT TË REVIZIONIMIT

Revizori pasi që të ketë përfunduar me revizionim do ta përpiloj raport-revizionimin.

Raport-revizionimi duhet të ketë një pamje të tërësishme ku do të përfshihen të gjitha pikat relevante. Ky raport duhet të përmbaj pjesën hyrëse, gjetjen dhe mendimin dhe sugjerimet e revizorit.

Në pjesën hyrëse paraqiten të dhënat: emërtimi i ndërmarrjes, selia, emri dhe mbiemri i revizorit që ka bërë revizionimin, data, objekti i revizionimit, koha e revizionimit etj. Në këtë pjesë jepen të dhëna për urdhër revizionim, përkatësisht kontrata për revizionim, zakonisht përmban të dhëna siç janë: emri dhe mbiemri i revizionit, koha e revizionimit. Se sa i kushtohet kujdes raport-revizionimit në vendet e zhvilluara kapitaliste, flasin edhe udhëzimet që jepen për përpilimin e tij. Ja një shembull të udhëzimeve që “Standard Oli Company” nga Kalifornia jep për hartimin e raport-revizionimit.

1. Zhvillo aftësinë, që njëkohësisht të jesh “lexues” dhe “përpilues” i raportit.

2. Paramendo rrethin e lexuesve, merri me mend njerëzit që do ta lexojnë raportin tendë, andaj shkruaj në një mënyrë të përshtatshme që do të zgjojë interesimin e tyre.

3. Katër kërkesa të njohura janë:

Përmbajtja: a ke prova për të gjitha të dhënat që i ke shënuar në raport

Interesi: a ke shkruar raportin në atë mënyrë që do ta ngjallë interesin e lexuesit.

Qartësia: a i ke shkruar faktet në atë mënyrë që lexuesi ta ketë qartë se ka dashur të thash e mos të mbetet në dilemë.

Teksti: a i ke shkruar faktet në atë mënyrë që do të krijojnë një atmosferë të mirë të volitshme.

4. Provoi faktet e tua me këto gjashtë fjalë: çka, kur, pse, kush dhe si ka ndodhur.

5. Qartësia e mendimeve shihet edhe në qartësinë e shkrimit.

6. Për të ngjallur dhe për ta mbajtur interesimin deri në fund, paramendo reagimin e lexuesve.

7. Për të qenë i qartë, faktet shtroji:

- -veç e veç
- -të liruar nga fjalët dhe të dhënat e tepërta
- -në një rrjedhë të logjikshme
- -me titull të shkurtër dhe me hyrje të qartë.

8. Ti je i interesuar çka do të ndodhë në bazë të raporteve tua .Kjo ka rëndësi më të madhe se sa të jesh tepër i ashpër në kritikë. Bashkëpunëtorët nuk e pëlqejnë kritikën e ashpër.

9. Mendo para se të flasësh e të shkruash.

Përpilimi i raport-revizionimit kërkon punë të madhe dhe këmbëngulëse .ky është kurorëzimi i tërë punës së tij të bërë gjatë revizionimit .Duke u mbështetur në të dhëna që revizori ose ekipi i revizionimit ka siguruar në shënimet e punës,përpilohet raport-revizionimi.

Përfundimi

Në këtë punim diplome rendësi të veçanta i kushtohet temës "Kontroll Revizioni i Marrëdhënieve me Banka"

Të fillosh nga nocioni "mbikëqyrje", kuptojmë se po vëzhgohet me kujdes kryerja e një detyre, zbatimin e ndonjë porosie apo mos shkeljen e ndonjë rregulli. Mbikëqyrja klasifikohet në dy grupe kryesore: e brendshme dhe e jashtme.

Në pjesën e dytë shpjegohet: kuptimi dhe definicioni i bankave. Bankat çfarë funksione kryejnë, llojet e bankave, kemi veçuar bankat komerciale, që janë më të shumtat dhe më të përhapurat në botë. Ato janë bazë e sistemit të ndërmjetësimit financiar sepse me punët e tyre i mobilizojnë depozitat dhe pastaj lejojnë kredi për plotësimin e nevojave të ekonomisë.

Kontrolli i Marrëdhënieve me Banka është pjesa e tretë, këtu kontrollohet mënyra e grumbullimit të mjeteve të bankës, plasmani i tyre kushtet e plasmanit, normat e kamatës, afatet dhe kushtet tjera.

Në pjesën e katërt përfshihet: Revizionimi i Raporteve Financiare i Bankave Afariste : Revizionimi i bankave komerciale - bankat luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e një vendi, ato mbledhin kursimet e publikut, japin mjetet e pagesës për mallrat dhe shërbimet dhe financojnë projekte për zhvillimin e prodhimit dhe të tregtisë. Se çfarë është përgjithësia e menaxhimit të bankës, kjo përgjegjësi bje mbi këshillin e menaxhimit dhe drejtuesve të caktuar. Roli i zakonshëm i mbikëqyrësit dhe e auditorit menaxhementit të janë në dobi të njëra tjetrës. Si shkon procedura e revizionimit të një banke, çfarë janë rreziqet.

Dhe në fund revizori pasi që të ketë përfunduar me revizionim do ta përpilojë raport-revizionimin. Përpilimi i raport-revizionimit kërkon punë të madhe dhe këmbëngulje. Kështu del në pah kultura profesionale dhe e përgjithshme e revizorit. Ky është kurorëzimi i tërë punës së tij

të bërë gjatë revizionimit.

Literatura

Dr.Hajrullah Gorani -“Kontrolli dhe revizioni i ndërmarrjes”UP Prishtinë1998

Grup autorësh-“Kontroll revizioni”Tiranë,2003

Dr.sc.Hysen Ismajli-“Kontrolli dhe revizioni”(ligjërata të autorizuara)Prishtinë 2004

Dr.Gazmend Luboteni-“Banka dhe Afarizëm Bankar”.....Prishtinë 2004